



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 22.4.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selviqe Halimi, Albulena Haxhiu, Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Enver Hoti.

Mungoi, përfaqësuesi nga GP- Lista Serbe.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Rushiti – GAP; Floriana Shala – OSBE; Floriana Merovci- ZPRK dhe Naim Jakaj, VV.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit, nr. 05-P-021;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit, nr. 05-P-021

Armend Zemaj, kryetar, i njoftoi anëtarët e Nënkomisionit se tanimë i kemi pranuar dokumentet që kanë të bëjnë me Projektligjin për Kuvendin dhe Rregulloren e punës. Ai, më tutje shtoi se tanimë kemi një dakordim që të punohet paralelisht në Projektligj dhe në

Rregullore, si dhe kemi përfshirë të gjithë ata që dëshirojnë të japin kontributin e tyre në punën e Nënkomisionit. Ju e dini se disa anëtarë që kemi qenë pjesë e Nënkomisionit në legjislaturën e kaluar, kemi punuar shumë në Rregulloren e punës dhe tani kemi për obligim që të angazhohemi në grupet tona parlamentare, që të kemi edhe mbështetjen e tyre që të ecim përpara, në mënyrë që mos të na përsëritet ajo, pra të punojmë dhe të mbetet në Kryesi puna jonë.

Albulena Haxhiu, tha se tani janë plotësuar kushtet që në takimin e radhës të Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të merret nisa për hartimin e Projektligjit dhe zyrtarisht Nënkomisioni të fillojë punën për hartimin e Projektligjit dhe Rregullores. Po ashtu, propozoi që tre anëtarë të Komisionit të marrin pjesë në mbledhjen e Kryesisë, me qëllim të harmonizimit të veprimeve lidhur me procedimin e Projektligjit për Kuvendin dhe Projektregulloren e Kuvendit.

Selivije Halimi, u pajtua që të merret nisma për hartimin e Projektligjit, pasi që kjo është edhe vërejtje nga Raporti i Progresit dhe ishte e mendimit që puna e Nënkomisionit të bëhet në punëtori, dy apo treditore, pasi që shkresa e Kryetarit të Kuvendit është që, gjatë sesionit pranveror, ta kemi në shqyrtim të parë Projektligjin dhe Rregulloren punës.

Pas diskutimeve, Nënkomisioni, duke vepruar në pajtim me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 05-P-021, vendosi që:

1. Në mbledhjen e radhës së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të merret nisma për hartimin e Projektligjit për Kuvendin.
2. Të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që në takimin e radhës të marrin pjesë: Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit dhe Armend Zemaj-kryesues i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që të harmonizohen veprimet lidhur me procedimin e Projektligjit për Kuvendin dhe Projektregulloren e Kuvendit.

3. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj